



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:175763

Datë: 29.03.2021

Numri i dokumentit: 01645854

C.nr.1061/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Raif Fazliu, në çështjen juridike të paditëses N.N (N.N) nga fshati Ramjan, Komuna e Vitisë, të cilën me autorizim e përfaqëson Hajriz Lubishtani avokat në Viti, kundër të paditurës Komuna e Vitisë, Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson Ekrem Shabani, zyrtar juridik pranë Drejtorisë Komunale të Arsimit, lidhur me pagesën e udhëtimit dhe kompensimin e ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë, vlera e kontestit 2,254 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur në praninë e përfaqësuesve të palëve me datë 26.03.2021 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I MIRATOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses N.N (N.N) nga Ramjani i Vitisë, **DETYROHET** e paditura Komuna e Vitisë, Drejtoria Komunale e Arsimit që t’ia paguaj paditëses pagesën e udhëtimit dhe kompensimin për ushqim – shujtave për ditët e pranisë në punë, shumat si vijon:

Në emër të ushqimit ditor, për periudhën prej 18.04.2017 deri me 18.12.2020, apo për 663 ditë të punës gjatë kësaj periode shumen prej 1,326 €, si dhe për 70%-shin e pagesës së biletave të udhëtimit për 663 ditë në relacionin Ramjan-Klllokot-Ballancë dhe anasjelltas shumën prej 928 €, apo gjithsej **2,254 euro**, të gjitha në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Vitisë, që t’ia paguaj paditëses N.N, shpenzimet e procedurës në shumën prej 260 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja N.N (N.N) nga fshati Ramjan, Komuna e Vitisë, përmes të autorizuarit të saj avokatit Hajriz Lubishtani, me datë 14.12.2020, ka parashtruar padi kundër të paditurës, Komuna e Vitisë lidhur me kompensimin kompensimin e ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë, si dhe pagesën e udhëtimit, pa e specifikuar shumën e përgjithshme.

Përfaqësuesi i saj ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie të punës tek e paditura në kohë të pacaktuar në shkollën fillore e mesme të ulët (SH.F.M.U.) “Safet Rexhepi” në Zhiti, paralelja e ndarë në Ballancë, e cila punon si mësimdhënëse-mësuese, ku e paditura nuk ka bërë kompensimin e pagesës së udhëtimit, e as kompensimin e ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë, nga data 18.04.2017.

Në bazë të Kontratës Kolektive të datës 18.04.2017, përfaqësuesi i saj kishte deklaruar se kërkojmë pagesën e udhëtimit, si dhe kompensimin e ushqimit-shujtave për ditët e pranisë në punë, në shumën e përgjithshme prej 2,254 €,

si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 260 euro, duke i specifikuar 104 € për përpilimin e padisë, 21 € taksa për padi dhe 135 €, për përfaqësimin e avokatit për një seancë gjyqësore.

I autorizuari i paditurës në përgjigje në padi ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses, për arsye se, kërkesat e saj nuk kanë bazë ligjore. DKA-ja dhe komuna nuk kanë të drejtë ligjore sipas Ligjit për Financat Publike të bëjë pagesën për paga dhe mëditje nga buxheti komunal. Pagat paguhen nga niveli qendror dhe në momentin kur të na ndahen mjete financiare nga niveli qendror, DKA-ja do ta bëjë pagesën e pagave jubilarë dhe beneficioneve tjera ashtu siq parashihen me Kontratën Kolektive nr.01B/2056, e datës 18.04.2017.

As Ligji i Punës nr.03/L-212, nuk i njeh këto të drejta dhe kompenzime për puntorët arsimorë, që t'i gëzojnë këto beneficione. Edhe Kontratën Kolektive për momentin nuk është duke e implementuar-zbatuar Qeveria e Republikës së Kosovës, andaj këto kërkesa më tepër janë të nivelit qendror, të Ministrisë për Administratë Publike dhe të Ministrisë së Financave, se sa që janë obligime për komunat, duke shtuar se kjo kategori është ngarkesë buxhetore për komunat, në këtë rast edhe për DKA-të. Propozoj që të refuzohet në tërësi kërkesëpadija e paditëses si e pa bazuar.

Në seancën e datës 26.03.2021, përfaqësuesi i paditëses avokati Hajriz Lubishtani, në tërësi kishte mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadiës, duke e specifikuar dhe precizuar atë dhe duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovon në tërësi si të bazuar, pasi që e njëjta mbështetet në provat konkrete, me çka lartësinë e kërkesës për pagesën e udhëtimit, si dhe kompensimin e ushqimit-shujtave, e kishte bazuar për ditët e pranisë në punë të paditëses, me vërtetimet që janë lëshuar nga shkolla "Safet Rexhepi" në Ballancë. Ishte tërhequr nga propozimi për nxjerrjen e provës me ekspertizë financiare, pasi që kemi të bëjmë me llogaritje të thjesht matematikore. Gjykatës i kishte dorëzuar precizimin e kërkesëpadiës, mbështetur në vërtetimet për ditët e pranisë në punë të paditëses. Përgjigjen në padi e kishte konsideruar si jo relevante, pavarësisht faktit se e paditura posedon apo jo mjete financiare, pasi që këtë të drejtë paditësit ia garanton Kontrata Kolektive e Arsimit nr. 01B nr. 2056, e datës 18.04.2017.

Kurse, përfaqësuesi i të paditurës Ekrem Shabani, e kishte kundërshtuar në tërësi padinë e paditëses, duke e arsyetuar kundërshtimin, sepse kjo padi nuk ka bazë ligjore.

DKA-komuna nuk ka të drejtë ligjore sipas Ligjit mbi Ndarjen Buxhetore në Republikën e Kosovës nr.06-L-133 neni 12 pika 4, ky ligj ndalon komunat që të paguajnë pagesat për paga dhe shujta, pasi që pagat dhe shujtat janë çështje të nivelit qëndron të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kishte shtuar se paditësja është në punë dhe në sistemin e pagave dhe asgjë nuk humbë deri sa të sigurohen mjetet financiare për këtë qëllim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sepse Komuna –DKA-të, nuk kanë buxhete për t'i paguar këto beneficione sipas Marrëveshjes Kolektive, andaj kishte kërkuar nga gjykata që këtë padi ta refuzojë si të pa bazë ligjore, sepse sipas Ligjit mbi Buxhetin e lartcekur DKA-ja nuk është përgjegjëse për paga dhe shujta, pasi që nuk është edhe nënshkruese e kësaj Marrëveshjes Kolektive.

- Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të kësaj çështje, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t'i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, ka administruar një sërë provash si: Kontrata e punës për mësimdhënës me kohë të pacaktuar nr.05-44-2012, e datës 01.09.2015, Kërkesën e paditëses nr.05-320/04-40419, datë 09.12.2020, Vërtetimin për paditësen N.N, nr.1/50, i datës 26.06.2020, i lëshuar nga SH.F.M.U. "Safet Rexhepi", Vërtetimi për të njëjtën, i datës 11.03.2021, disa bileta udhëtimi në relacionin Ramjan-Klllokot-Basllancë dhe Regjistri i pagave i Ministrisë së Financave. Palët nuk kishin vërejtje në provat e administruara.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditëses, av. Hajriz Lubishtani, kishte thënë se nga provat e administruara baza juridike nuk është në asnjë çast kontestuese, andaj edhe njëherë e kishte precizuar kërkesën e paditësit, sikur shumat e gjykuara.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i të paditurës DKA, jurist Ekrem Shabani, kishte mbetur pranë thënies të mëparshme, veçanërisht pranë përgjigjes në padi, duke kërkuar nga gjykata që

padinë ta refuzoj si të pa bazuar, pasi që DKA-ja, Komuna e Vitisë nuk janë përgjegjëse që nuk është zbatuar Kontrata Kolektive e vitit 2017, nga palët nënshkruese Ministria e Arsimit dhe SBASHK-u. Po ashtu përgjegjëse janë Ministrinë të Republikës së Kosovës, të cilat nuk kanë siguruar buxhet shtesë për këtë kategori të punëtorëve arsimor, për kompensimin e pagave jubilarë dhe beneficioneve tjera që parashihen me këtë kontratë.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve dhe provave të lartë cekura, në kuptim të nenit 8, të LPK-së, me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, duke gjetur se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar.

- Me leximin e Kërkesës së paditëses nr.05-320/04-40419, datë 09.12.2020, vërtetohet se paditësja vërtetohet se paditësja i kishte shterë mundësitë që në procedurën administrative, ta realizoj kërkesën e saj, andaj me të drejtë ju kishte drejtuar gjykatës, për realizimin e drejtës subjektive të saj.

- Me leximin e Vërtetimit për paditësen N.N, nr. 1/50, i datës 26.06.2020, i lëshuar nga SH.F.M.U. “Safet Rexhepi” në Ballancë, gjykata ka vërtetuar se paditësja punon në atë shkollë, në vendin e punës si mësimdhënëse – mësuese, e cila punon me kontratë të punës së përhershme nga data 22.09.2014, pra ka përvojë pune prej mbi 7 viteve.

- Me leximin e Vërtetimit të datës 11.03.2021, i lëshuar nga SH.F.M.U. “Safet Rexhepi” në Ballancë, gjykata ka vërtetuar se paditësja në vitin shkollor 2016/17, ka 41 ditë mësimi, 2017/18, ka 185 ditë, 2018/19, ka 185 ditë, 2019/20, ka 185 ditë mësimi, kurse 2020/21, ka 67 ditë mësimi, apo gjithsej ka 663 ditë mësimi. Pra, është përfshirë periudha nga data 18.04.2017 deri më 18.12.2020.

Me leximin e vërtetimit të datës 13.01.2021, i lëshuar nga kompanitë për transportimin e udhëtarëve në territorin e komunës së Vitisë, vërtetohet se paditësja për të vijuar në shkollën ku punon, ajo duhet të udhëtoj në relacionin Ramjan-Kllokot-Ballancë dhe anasjelltas, ku biletat e udhëtimit në këtë relacion kushtojnë 2 €, ndërsa 70%-shi i tyre llogaritet 1.40 €, ndërsa kur e shumëzojmë me 663 ditë të vijimit në shtëpi-shkollë-shtëpi, na jep shumën për udhëtim prej 928 €. Lartësia e biletës vërtetohet nga vërtetimi i kompanive të transportit të udhëtarëve që veprojnë në kuadrin e komunës së Vitisë.

Me leximin e gjitha këtyre provave vërtetohet se paditësja kishte mbajtur 663 ditë mësimi, të përcaktuar si në saktësimin e padisë, e që kur e shumëzojmë here 2 euro, na del shuma prej 1,326 €, kurse kur shumëzojmë 663 ditë të vijimit nga shtëpia-shkollë-shtëpi, të paditëses here 2 €, për çdo ditë, ndërsa 70%-shi i tyre llogaritet 1.40 €, na jep shumën për udhëtim prej 928 €, e krejt në fund na del shuma e përgjithshme prej 2,254 €.

Gjykata konstaton se ndërmjet palëve nuk ishin kontestuese faktet se paditësja është e punësuar në shkollën dhe pozitën përkatëse siç i cekëm më lartë.

Gjykata vlerëson se paditëses i takon e drejta në realizimin e pagesës në udhëtim konform nenit 35, pika 5, ndërsa kompensimi në ushqim gjatë punës bazuar në nenin 35, pika 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017.

Sa i përket pretendimit të autorizuarit të paditurës se komuna nuk ka të drejtë ligjore sipas Ligjit për Ndarjen Buxhetore në Republikën e Kosovës nr.06-L-133 neni 12 pika 4, ku ky ligj ndalon komunat që të paguajnë pagesat për paga dhe shujta, pasi që pagat dhe shujtat janë çështje të nivelit qëndron të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pastaj se paditësja është në punë dhe në sistemin e pagave dhe asgjë nuk humb deri sa të sigurohen mjetet financiare për këtë destinim nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sepse Komuna –DKA-të, nuk kanë buxhete për ti paguar këto beneficione sipas marrëveshjes kolektive, këto pretendime janë të parëndësishme për gjykatën, andaj si të tilla nuk ka nevojë të arsyetohen.

Neni 35.5, i Kontratës thotë: *”Punonjësit arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*

Kurse në nenin 35, pika 7, të Kontratës së njëjtë thuhet: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit për një ditë të pranisë në punë është 2 €”.*

Pagat e shërbyesve civilë, sektorit të arsimit, shëndetësisë e tjera, financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe Komuna e Vitisë është organizatë buxhetore e nivelit lokal, po ashtu e paditura pranon edhe grande të ndryshme dhe të hyra vetanake. Kontrata Kolektive e lidhur ndërmjet SBASHK-ut dhe Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë (Qeveria e Republikës së Kosovës) prodhon efekte juridike nga data e lidhjes së saj me 18.04.2017, dhe e paditura si organizatë buxhetore e nivelit lokal është e detyruar t’ia paguaj paditësit shumën si në dispozitivin e këtij Aktgjykimi.

Neni 2. i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë në fushën e zbatimit të kontratës veç tjerash përcakton se dispozitat e Kontratës Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (Komunat – DKA-të, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in e tjera) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Gjykata miratimin e kërkesëpadisë së paditëses e ka bazuar në Ligjin e Punës nenet 10, 55 dhe 80, Kushtetutën e Republikës së Kosovës nenet, 3, 22, 24, 31, 32, 49 dhe 54, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore neni 6 dhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë neni 35, pikat 5, 7 dhe 8.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është bazuar në nenin 452.1, të LPK-së dhe Tarifën e Odës së Avokatëve .

Gjykata vërtetoi se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për të vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, e duke u bazuar në nenin 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN–DEGA NË VITI

C.nr.1061/2020

Më: 26.03.2021

Gj y q t a r i,
Raif Fazliu

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e cila dorëzohet përmes kësaj gjykate.

